



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**LEGJISLATURA V**

**Sesioni vjeshtor**

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës  
Mbledhja nr. 40

Prishtinë, më 11.11. 2016, në orën 1:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**I Mbledhjes së Komisionit për Punë të Brendshme, Siguri dhe  
Mbukëqyrje të Forcës së Sigurisë së Kosovës**

**Në mbledhje morën pjesë:** Daut Haradinaj, kryetar, Rexhep Selimi, Anton Quni, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami, Nuredin Ibishi, anëtarë.

Munguan: Bojan Mitiq dhe Zafir Berisha.

**Përfaqësuesit nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës:** Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, Bekim Podrimqaku, drejtor i Departamentit për Analiza dhe Politikat e Sigurisë, Këshilli i Sigurisë së Kosovës dhe Shaqir Shaqiri, zyrtar në Sekretariatit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Agnesa Haxhiu, KDI; Blend Zyrapit dhe Gent Gjokolli, KIPRED.

**Nga Staf i mbështetës i Komisionit:** Nur Çeku dhe Zarë Aliu.

**Mbledhjen e kryesoi,** Daut Haradinaj, kryetar i Komisionit.

*Kryesuesi i Komisionit konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.*

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, e mbajtur më datë 5.10.2016;
3. Raportimi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
4. Të ndryshme.

**Kryesuesi**, fillimisht theksoi se z. Fadil Demaku, nënkryetar i parë i Komisionit, ka dhënë dorëheqje dhe jemi në pritje të zëvendësimit të tij.

### **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Kryesuesi konstatoi miratimin e rendit të ditës, pa ndryshime.*

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, e mbajtur më datë 5.10.2016.**

*Procesverbali u miratua pa vërejtje.*

### **3. Raportimi i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës**

**Kryetari**, fillimisht fjalën ia dha fjalën z. Afrim Haxhiut, për të njoftuar Komisionin me kushtet e punës, gjendjen financiare, mënyrën e raportimit në Qeveri dhe në institucionet tjera të sigurisë.

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**, fillimisht njoftoi se Këshilli i Sigurisë së Kosovës është themeluar në vitin 2009 dhe që nga themelimi e deri tani, i ka mbajtur 21 takime. Gjatë vitit 2016, janë mbajtur dy takime dhe është përgjegjësi e Kryeministrit të thërrasë takime. Në funksionimin e tij, Këshilli i Sigurisë së Kosovës, mbështet nga Sekretariati i Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe nga Qendra e Situatave, si dhe Komisioni i Inteligjencës, që përbëhet nga përfaqësues nga Policia e Kosovës, Agjencia e Inteligjencës, Dogana dhe se raportet janë të mira me Ministrinë e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe institucionet tjera. Sa i përket kushteve të punës, theksoi se nuk janë të mira dhe është hapësirë e ngushtë, ndërsa sa i përket buxhetit, shtoi se përveç buxhetit të ndarë, nuk kanë marrë shtesa.

Buxheti i Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës është 369900€, duke shtuar se sa i përket raportimeve në media, që ka pasur shpenzime për udhëtime dhe trajnime jashtë vendit, shtoi se nuk është e vërtetë, pasi janë shpenzuar vetëm 7200€ nga 30.000€, që janë në dispozicion, për këtë qëllim. Përgjegjësitë e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, janë të përcaktuara me Ligjin për Këshillin e Sigurisë, ku ka për detyrë përgatitjen e raporteve analitike, koordinimin

e hartimit të strategjive të Kosovës, ndërsa Qendra e Menaxhimit të Situatave është qendër operationale, që mbështet menaxhimin e krizave, siç ka qenë rasti në Restelicë, si pasojë e reshjeve të borës etj.

Më tutje, theksoi se në kushte normale i përgjigjet Kryeministrit, ndërsa në kushte të jashtëzakonshme, Presidentit të Republikës së Kosovës.

**Kryetari** shtroi pyetjen: Pse nuk është ftuar Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së në takime?

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**, theksoi se kjo është çështje e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dhe jo e sekretarit të Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

**Rexhep Selimi**, duke u ndërlidhur me fjalën e z. Haxhiu, theksoi se kushtet e punës në këtë institucion janë shumë të këqija. Më tutje, e konsideroi si shqetësuese që Këshilli i Sigurisë është mbledhur vetëm dy herë në këtë vit, duke shtuar se kryetari i Komisionit është anëtar ex-officio i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, duke theksuar se çështja e mospërfshirjes së Komisionit për punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, do të duhej të kthehej në agjendën e Kuvendit të Kosovës, për të debatuar për këtë çështje.

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**, duke iu referuar fjalës së z. Rexhep Selimi, theksoi se nga ana e Sekretariatit të Këshillit janë realizuar një sërë vizitash, por që kompetencat që ka Sekretariati, kaq mund të bëjë.

**Bekim Podrimçaku, drejtor i Departamentit për Analiza dhe Politikat e Sigurisë**, njoftoi për aktivitetet e realizuara nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, duke theksuar se Sekretariati është i autorizuar, me vendim, që të monitorojë Strategjinë për luftimin e ekstremizmi dhe radikalizmit, që shpie në terrorizëm. Gjithashtu, nga ana e tyre koordinohen të gjitha aktivitetet e institucioneve relevante të sigurisë dhe ka koordinuar edhe analizën e rishikimit strategjik të sektorit të sigurisë. Më tutje, theksoi se janë prezent edhe në pjesëmarrjen e grupeve punuese, ku shqyrtohen projektligje, që lidhen me fushën e sigurisë.

**Kryetari**, shtroi pyetjen si vijon: Pse nuk është planifikuar që edhe Komisioni për Siguri të përfshihet në Komisionin për Mbikëqyrjen e Strategjisë për luftimin e terrorizmit?

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës**, theksoi se miratimi i kësaj strategjie është bërë nga Qeveria dhe përbërja e grupit të punës është përcaktuar nga ekzekutivi dhe koordinator është këshilltari i Kryeministrit.

**Kryetari**, shtoi se këtë çështje do ta paraqesë edhe në seancë plenare dhe do t'i bëjë pyetje parlamentare Kryeministrit.

**Nuredin Ibishi**, lidhur me takimin e realizuar nga Këshilli i Sigurisë, shtroi pyetjet: Sa janë transparente takimet e mbajtura? Çështjet, të cilat mund të jenë me interes për opinion, a bëhen publike? Në cilën fazë është Strategjia e Sigurisë së Kosovës? Më tej, shtoi se Komisioni do të jetë i gatshëm për të mbështetur dhe adresuar shqetësimet e këtij institucioni.

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës,** në përgjigjeje të pyetjeve të z. Ibishi, theksoi se Strategjia e vitit 2010, ka qenë si një dokument, sa për të thënë dhe është bërë në kohën kur kemi qenë nën mbikëqyrje të autoriteteve ndërkombëtare. Ndërsa, sa i përket Strategjisë së re, theksoi se rekomandimi është dhënë nga analiza e rishikimit strategjik, për të shkruar strategjinë, si dhe si kërkesë e Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim. Po ashtu, theksoi se Sekretariati është i gatshëm kurdo që Këshilli i Sigurisë do të marrë vendim për formimin e grupit të punës për hartimin e kësaj strategjie.

**Kryetari,** theksoi se aspekti i mbikëqyrjes financiare është shumë i rëndësishëm, për të cilën gjë është kritikuar edhe në Raportin e Progresit, prandaj kërkoi që nga ana e Sekretariatit të ofrohet një tabelë e shpenzimeve financiare, për të parë se si janë shpenzuar, si dhe planifikimet për rritje të buxhetit.

**Ganimete Musliu,** shtroi pyetjet si vijon: A është bërë kërkesë buxhetore nga ana e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë, për planifikimin dhe rritjen e buxhetit për vitet në vijim? Si i vlerëson kapacitetet aktuale të Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë?

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës,** theksoi se në vazhdimësi është theksuar mungesa e stafit, pasi gjithsej janë 26 (njëzet e gjashtë) punëtorë, ndërsa 2 zyrtarë do të largohen, për shkak të moskalimit të procesit të verifikimit, nëse gjykata e vlerëson se nuk mund të vazhdojnë. Ndërsa, sa i përket planifikimit buxhetor, theksoi se kjo kërkesë bëhet si shabllon dhe nuk ka pasur kërkesë konkrete. Sa i përket kapaciteteve, theksoi se nuk janë keq, pasi që kanë kuadër të trajnuar në fushën e sigurisë, por sfida mbetet numri i vogël i punëtorëve.

**Kryetari,** propozoi që javën e ardhshme të realizohet një vizitë pune në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë, për t'u njohur më afër me kushtet e punës dhe aspekte të tjera konkrete.

**Qerim Bajrami,** pyeti: Sa janë të punësuar nga komuniteti jo shumicë në Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë?

**Afrim Haxhiu, sekretar i Këshillit të Sigurisë së Kosovës,** në përgjigjeje të pyetjes së z. Bajrami, tha se ka qenë një zyrtar nga komuniteti turk, por që aktualisht nuk ka zyrtar nga komunitetet jo shumicë.

**Kryetari,** falënderoi për këtë prezantim nga zyrtarët e Sekretariatit të Këshillit të Sigurisë.

#### 4. Të ndryshme

**Kryetari,** njoftoi për tryezën që do të organizohet nga DCAF( Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura), e cila do të mbahet më datë 30 nëntor, për rolin e parlamenteve për mbikëqyrjen e strategjive në luftën kundër terrorizmit dhe propozoi që të ketë një përfaqësim të Komisionit në këtë tryezë, me një prezantim.

Rexhep Selimi, propozoi që të bëhet një vizitë tek zyrat e Policisë së Kosovës, për t'u njohur më afër me situatën aktuale, sa i përket luftimit të terrorizmit, si dhe propozoi që kryetari i Komisionit, të bëjë një rezymë, në emër të Komisionit, në tryezën e organizuar nga DCAF. Gjithashtu, duke cilësuar raportin e KDI-së për punën e Komisionit, theksoi se duhet të jenë më bashkëpunues, për shkak se nuk janë pasqyruar ashtu si duhet aktivitetet e realizuara nga Komisioni.

**Kryesuesi**, me këtë pikë të rendit të ditës, e konsideroi mbledhjen e mbyllur.

Mbledhja përfundoi në orën 12:05.

**E përgatiti:**  
**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit,**

---

**Daut Haradinaj**